

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA E STUDENTEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **1020890500-25-3300-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me paisje industriale ne kuzhine (Paisje per rifunksionalizimin e Menzes se Studenteve)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Osa -Termosistem
NUI	810394255
Adresa	Rr Bernjak pn
Vendi	Rahovec
Kodi postar	21000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Arian Osa
Adresa elektronike	osatermosistemprokurim@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	10.06.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me pajisje industriale në kuzhinë (Pajisje për rifunksionalizimin e Menzes së Studenteve)

Furnizim me pajisje industriale në kuzhinë (Pajisje për rifunksionalizimin e Menzes së Studenteve)

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: Furnizim me pajisje industriale në kuzhinë (Pajisje për rifunksionalizimin e Menzes së Studenteve) me nr të prokurimit 1020890500-25-3300-1-2-1

Njoftimi për kontratë është bërë me datën 24.04.2025 është bërë publikimi në e-prokurim Njoftimi për kontratë dhe afati i fundit për dorëzimin e tenderit ka qenë 14.05.2025 në ora 13:00

Kriteri për dhënien e kontratës është: Çmimi më i ulët

Me datën 14.04.2025 është bërë hapja e ofertave dhe oferta jone është me e lirë me çmime prej 44.933.25 euro

Me datën 29.05.2025 AK ka marrë vendim që OE MSI shpik ta shpërblejë me kontratë dhe kompaninë tona ta eliminojë nga gara.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 01.06.2025 kemi dorëzuar pranë AK nepermjet e-prokurimit kërkesën për rishqyrtim

Me datën 03.06.2025 AK ka marrë vendim duke e refuzuar si të pabazuar kërkesën tone për rishqyrtim. Andaj të paknaqur me këtë vendim po i drejtohem OSHP-se me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. Neni 1 LPP Qellimi
2. Neni 6 LPP Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
3. Neni 7 LPP Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
4. Neni 10 LPP Mjetet për promovimin e transparencës
4. Neni 59 LPP Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
5. Neni 60 LPP Kriteret për dhenje të kontratës
6. Neni 65 LPP Pranueshmeria e Kandidatëve ose Tenderuesve
7. Neni 40 i Rregullores NR 02/2024 për prokurimin publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datën 29.05.2025, kemi pranuar vendimin e AK-së për Furnizim me pajisje industriale në kuzhinë (pajisje për rifunksionalizimin e Menzës së Studentëve) me nr të prokurimit 1020890500-25-3300-1-2-1. Sipas këtij vendimi, kompania jonë, Osa Termosistem Sh.p.k., nuk është shpërblyer me kontratë, edhe pse kemi ofruar çmim më të lirë, prej

44,933.25 Euro, ndërsa kontratë i është dhënë operatorit ekonomik të dytë, në radhe, me vlerë prej 47,370.00 Euro.

Bazuar në argumentimin për eliminim nga gara, vendimi është marrë mbi bazën e:

1. Nenit 72 të Rregullores së Prokurimit Publik,
2. Vendimit të datës 13.03.2025 mbi ndërprerjen e kontratës.

Ne arsetim te refuzimit te kerkeses per rishqyrtim eshte shtuar edhe

3. Kerkes per zbatimin e nenit 99.2 bashkangjitur arsyetimit, qe eshte proceduar ndaj OE Osa-Termosistem shpk

- Nenit 72 të Rregullores së Prokurimit Publik, të përdorur si bazë ligjore për vendimin e mare është i papërshtatshëm për këtë rastë, pasi ai trajton vetëm ndërprerjen e kontratës, dhe jo mos dhënien e kontratës në një aktivitet të prokurimit. Përdorimi i këtij neni për të penguar dhënien e kontratës së re është i padrejtë.

- Vendimi i datës 13.03.2025 mbi ndërprerjen e kontratës është marrë pa bazë ligjore dhe i pasë-afatshëm pasi validiteti i kontratës ka skaduar me 05.03.2025 dhe vendimit për ndërprerje të kontratës është marë me 13.03.2025, dhe ky vendim është marë për një aktivitet tjetër të prokurimit dhe vendimi nuk është mbështetur në asnjë bazë ligjore. Per informacion ne si OE kemi ngritur padi ndaj AK per shkelje te kushteve te kontrates dhe mos ekzekutim te asaj kontrate.

- Ne bazë të vendimit të refuzimit, të kërkesës për rishqyrtim, në pikën 3, e cila pikë nuk ishte në vendimin për eliminim por është shtuar në këtë aktëvendim, AK ka derguar në OSHP kerkes per diskualifikim te kompanis tone nga pjesmarja në aktivitetet e prokurimit publik.

Ne me të kuptuar këtë i jemi drejtuar OSHP nëpërmjet emailit me kërkes për infomat nëse ka ndonje kërkes pranë OSHP kundër neve si OE të parashtruar nga AK.

Deri në dorzimin e kësaj ankese nuk kemi pranuar asnjë informacion nga OSHP.

Shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregulloreve në fuqi:

Neni 1 i Ligjit për Prokurimin Publik parashikon që qëllimi është sigurimi më efikase, më transparente dhe të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

Neni 6 i Ligjit, pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk kanë luajtur rol aktiv për tëu siguruar se fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kriterëve të parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit për këtë procedurë. Mos aplikimi si duhet i kërkesave të parapara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit e shtynë AK në jo vetëm drejt shkeljes së nenit 6 të LPP-së por edhe drejt shkeljeve tjera sepse me këtë veprim po tenton që në kundërshtim me realitetin dhe në kundërshtim me nenin 60 të LPP-së të e kontraktoj një OE që e posedon çmimin shumë më të lartë se ne. Ne jemi tenderues plotësisht i përgjegjshëm andaj tentimi për shpallje si fitues i një OE që posedon çmimin më të lartë se ne, konsiderohet shkelje e plotë e shfrytëzueshmërisë së mjeteve në formën efikase, efektive dhe ekonomike siç e kërkon nenin 6 i LPP-së. Bazuar në këtë që e thamë më lartë, konstatohet lehtë se AK ka shkelur nenin 6 të LPP-së duke mos vlerësuar në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e neneve tjera që do të i cekim në pretendimet tjera.

Neni 7 i Ligjit, pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë sepse neve na ka diskriminuar duke aplikuar në mënyrë të gabuar dispozitat e LPP.

Arsyeja e AK-së për eliminim nuk përkon fare me realitetin dhe sipas asaj që shihet është veprim tendencioz dhe i qëllimshëm vetëm sa për të mos na shpallur neve si fitues.

Ky veprim i AK-së përpos që bie ndesh me kërkesat dhe kriteret e dosjes së tenderit, bie ndesh edhe me dispozitat ligjore të LPP-së dhe RRPP-së respektivisht nenin 65 që pranueshmërisë së kandidatëve ose tenderuesve ku kompania jonë nuk është shpallur i papranueshem ose i është ndaluar pjesmarja në një aktivitet të prokurimit nga ndonjë gjykatë kompetente sic e parasheh neni 65 i LPP.

Kjo përpos që përbën shkelje të nenit 60 të LPP-së, përbën edhe shkelje të nenit 6 të LPP-së si dhe shkelje të nenin 28 dhe 30 të RRPP-001/2022 lidhur me ekonomikitetin e shpenzimit të parasë publike si dhe përgjigjen në vazhdimin e ofertës dhe të sigurimit të tenderit. Në veçanti kjo përbën edhe shkelje të nenit 7 të LPP-së lidhur me favorizimin e OE të

shpallur fitues përkatësisht diskriminim tonë.

Bazuar në këtë lirisht mund të themi se AK gjatë procesit të rishqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim, ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit mbi trajtimin e drejtë, favorizimin dhe në të njëjtën kohë diskriminimin e tenderuesve. Ne si operatorë ekonomike jemi diskriminuar pasi që vendimi i AK për eliminim është pa bazë ligjore është i dëmshëm dhe i papranueshëm.

Neni 59 i Ligjit, pasi që gjatë vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit të publikuar për këtë qëllim.

AK ka bërë shkelje të plotë të nenit 59 të LPP-së me rastin e eliminimit tonë nga konkurrenca.

Arsyetimi i AK-së duket kështu:

ARSYETIM: *Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:*

Refuzohet oferta juaj bazuar ne :

- 1. Neni 72 te Rregullores per Prokurimin Publik.**
- 2. Vendindimit te dates 13.03.2025 mbi nderprerjen e kontrates**

Bazuar ne arsyetim të AK për eliminim oferta jonë as nuk është vlersur, krahasuar dhe as nuk kanë sqauar pasi që është eliminuar me pretendime të pabazuar dhe arbitrare, ku AK ka marrë rolin që nuk i takonë, të organit gjyqësorë, duke marrë vendime dhe duke ndaluar pjesmarjen në aktivitetet e prokurimit të kompanis sonë.

Sipas LPP këtë të drejtë i takonë vetë organeve gjyqësore dhe jo AK.

Neni 60 i Ligjit, mbi kriteret për dhënien e kontratës, pasi që nuk i ka respektuar dispozitat në të cilat thuhet se OE duhet së pari të jetë i përgjegjshëm e pastaj të posedoj edhe çmimin më të ulët në krahasim me tenderuesit tjerë të përgjegjshëm. Në rastin tonë ne jemi tenderues komplet i

përgjegjshëm dhe jemi tenderuesi me çmimin më të ulët nga të gjithë tenderuesit tjerë andaj me të drejtë konstatojmë se AK e ka shkelur nenin 60 të LPP-së.
Ne kemi dorëzuar ofertën më të lirë, për 2.436.75 Euro se oferta e përzgjedhur.

Neni 65 i Ligjit, mbi pranueshmërinë e kandidatëve dhe tenderuesve, parashikon kushtet kur një operator ekonomik nuk ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitetet e prokurimit.
Nuk ka asnjë ndalesë ligjore për kompaninë tonë për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit, dhe ne nuk kemi shkelur asnjë prej këtyre kushteve.

Neni 10 i Ligjit, mbi mjetet për promovimin e transparencës, pasi që AK nuk na ka leju qasje në të gjithë dosjen e këtijë aktiviteti të prokurimit si që është Raporti i komisionit të vlerësimit ku do të mund të vërtetohet se si është vlerësuar oferta jonë a është vlersuar drejt.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdesë kërkesën tonë dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marrë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE OSA TERMOSISTEM SHPK lidhur me tenderin Furnizim me paisje industriale ne kuzhine (Paisje per rifunksionalizimin e Menzes se Studenteve)

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - QENDRA E STUDENTEVE dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar ne kërkesat e dosjes së tenderit, në dispozitat e LPPsë, dhe në interpretimet e KRPP-së e që realisht më

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e

kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

Neve si Ofertues në këtë aktivitet të prokurimit kemi shpenzime të konsiderueshme për rishqyrtim të vendimit në AK në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë procedurë të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në fazën e parë përfaqësimeve të cilat ndodhin etj.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material e i cili shtrihet edhe në raport neni 136 dhe Neni 137 të LMD-së duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraparak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*